

REKTORI

URDHËR

Nr. 3, Datë 21. 03. 2020


**PËR ZHVILLIMIN E PROCESIT MËSIMOR NË PLATFORMËN ONLINE ME
STUDENTËT E UNIVERSITETIT “LUARASI”**

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 4, të Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 156, datë 10.03.2020, "Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", Satutin e Universitetit “Luarasi”, në cilësinë e Rektorit të Universitetit “Luarasi”:

URDHËROJ

1. Zhvillimin e procesit mësimor në platformën online “Moodle Luarasi-LMS” me studentët e ciklit të parë dhe të dytë, sipas vlerësimeve të njësive kryesore të Universitetit “Luarasi”, por gjithmonë duke ruajtur standardet bazë të mësimdhënies.
2. Njësiti kryesor, pasi të kenë analizuar dhe vlerësuar platformën e mësimdhënies online “Moodle Luarasi-LMS”, që mund të operojnë në bazë departamenti/fakulteti, të bëjnë testimin dhe pilotimin e leksioneve online sa më parë.
3. Njësiti kryesor, pasi të kenë bërë testimin dhe pilotimin e leksioneve online, të sigurohen që janë depozituar në platformën e mësimdhënies online “Moodle Luarasi-LMS” leksionet për çdo lëndë/modul për të gjithë programet që ofrojnë, **brenda datës 23 mars 2020**.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhëri Zv/Rektori për anën kërkimore-shkencore, Administratori i Përgjithshëm, Drejtuesit e njësive kryesore të Universitetit “Luarasi”.
5. Ky urdhër ka karakter të përkohshëm dhe do të zbatohet për aq kohë sa zgjat periudha e pezullimit të procesit mësimor për shkak të COVID-19.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Prof. Dr. Ethem RUKA
REKTOR

